

**Raporti i vlerësimit të cilësisë për vitin akademik 2023/2024**  
**Fakulteti Menaxhmenti**  
**Programi: Menaxhim i Biznesit dhe Ndërmarrësia**

- **Hyrja**

Fakulteti Menaxhmenti ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente moderne të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathtësitë e duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen. Programi Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia (MBN) në kuadër të Fakultetit Menaxhmenti gjatë vitit akademik 2023/24 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar 2022/25 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) si vazhdimësi e programit Menaxhment Industrial (i Akredituar për vitet 2019/22).

Programi MBN u ofron studentëve njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e biznesit dhe të menduarit ndërmarrës, në inovacione, në planifikim të aktiviteteve biznesore, njohuri për komunikimin në biznes, dhe njohuri, aftësi dhe shkathtësi tjera të ndërlidhura me Menaxhim Biznesi dhe Ndërmarrësi.

Misioni i programit është të përgatisë kuadro të cilët përmes metodave moderne në menaxhimin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrësisë do të kontribuojnë në ndryshime të vazhdueshme të ambientit biznesor, Misioni i programit është në harmoni të plotë me misionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.


Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2023/2024 përmban të dhëna për vlerësimin e programit dhe për vlerësimin e stafit akademik/lëndës, i cili raport krahasohet me dy vitet paraprake.

## 1. Raporti i përmbledhur i vlerësimit të cilësisë (program, stafi akademik/lënda)

Raporti i përgjithshëm - për dy fusha (program dhe stafi akademik/lënda), paraqitet në Tabelën nr. 1 – të dhënat për vitin akademik 2023/24 (krahasuar me dy vitet paraprake), i ilustruar edhe në Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

**Tabela.nr.1** - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave (programi dhe stafi akademik)

	Vitet Paraprake		Viti aktual
	2021/22	2022/23	2023/24
Vlerësimi i stafit akademik/lënda	4.20	4.23	4.26
Vlerësimi mësimdhënia/nxënia (programi)	4.06	4.00	3.88



**Fig.1 – Grafika - vlerësimi i cilësisë sipas fushave (programi dhe stafi akademik),**

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.1 dhe të pasqyruara në grafikun nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim një vlerësim konstant të cilësisë nëpër tri vitet akademike (2021/22, 2022/23 dhe 2023/24). Duke iu referuar tabelës dhe grafikun nr.1 - programi MBN ( për vitin akademik 2023/24) është vlerësuar me

notën 3.88 apo vlerësimi në përqindje nga studentët për programin MBN është rreth 80%, që konsiderohet një vlerësim shumë i mirë. Në kuadër të fushës të vlerësimit të stafit akademik/lëndës është një vlerësim konstant nga studentët (me një ngritje të lehtë) nëpër vitet akademike (2021/22, 2022/23 dhe 2023/24). Duke iu referuar tabelës dhe grafikonit nr.1 për vitin akademik 2023/24 vlerësimi për stafin akademik/lëndën është me notën 4.26 apo rreth 85% është vlerësimi në përqindje - është një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e stafit akademik dhe lëndën e ligjëruar.

## 2. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia (MBN) 2023/24 (i krahasuar me dy vitet paraprake) është realizuar përmes pyetësorëve i cili përmban 21 komponentë, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Bazuar në rezultate e vlerësimit të programi - mësimdhënia dhe mësim-nxënia të paraqitura në Tabelën nr.2, vërejmë se të gjitha komponentët e këtij sesi janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare e vlerësimit të programit është 3.88 që është një vlerësim shumë i mirë – i cili kërkon angazhim për tu përmirësuar në vitin pasues.

**Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – MBN**

Nr.		Vitet paraprake		Viti aktual
		2021/22	2022/23	2023/24
1	Materialet e prezantuara gjatë ligjëratave ju ofrohen studentëve rregullisht	4.04	4.00	3.80
2	Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.17	4.00	3.98
3	Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve	4.14	4.10	3.92
4	Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve	4.08	3.90	3.89
5	Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet	3.98	3.85	3.80
6	Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse	4.15	4.00	4.03
7	Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimnxënies	4.10	3.90	3.81
8	Mësimi online (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shume nga ai në klasë	3.74	3.95	3.75

9	Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve	4.02	3.90	4.02
10	Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë	4.15	3.85	3.81
11	Ekziston një lidhje e mirë e mësimit teorik dhe atij praktik	4.03	3.80	3.70
12	Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore	4.16	3.85	3.94
13	Orari i mësimit shpallet me kohë	4.09	3.95	3.82
14	Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mesimdhënësit	4.04	3.95	3.83
15	Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës	4.08	3.85	3.81
16	Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera	4.04	3.85	3.80
17	Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar)	4.08	3.75	3.80
18	Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti	3.99	3.75	3.65
19	Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.97	3.75	3.75
20	Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv	4.13	4.00	3.90
21	Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve	4.08	3.85	3.90
	<b>Mesatarja e vlerësimit të programit</b>	<b>4.06</b>	<b>4.00</b>	<b>3.88</b>

Nga analiza e të dhënave vijmë në përfundimin se vlerësimi përfundimtar në nivel të programit është afër notes 4 që është një vlerësim shume i mire, vlerësimi për vitin aktual është me i ulet se sa ai i vitit paraprak prandaj në këtë drejtim ka hapësirë për angazhim shtesë nga menaxhmenti i fakultetit dhe stafi i angazhuar në mësim pranë Fakultetit. Duke u bazuar në rezultatet e përpunuara nga të dhënat e mbledhura në sistemin SMU për vlerësimin e programit – rrjedh se duhet synuar përmirësim të vazhdueshëm në komponentët që kërkojnë një angazhim ma të madhë – që janë: Lidhja e mësimit teorike me praktike që organizohet nga Universiteti, Orari i konsultimeve studentë – profesor, Puna praktike jashtë institucionit, Mësimi “on-line” përmes platformës Microsoft Tims (e cila platformë pas pandemisë CoVid-19 është përdorur vetëm për komunikim studentë-profesor përmes Tims), Angazhimi i balancuar i studentëve për lëndë, Informimi i studentëve për mundësin e punësimit pas përfundimit të studimeve, – për këto komponente duhet angazhim i menaxhmentit, komitetit të programit dhe organizim më i mirë i stafit për ngritje të cilësisë dhe të rezultateve.

### 3. Raporti i vlerësimit te stafit akademik/lëndës

Raporti i vlerësimit për stafin akademik/lëndën në kuadër të programit MBN, paraqet të dhëna për vitin akademik 2023/24 (krahasuar me dy vitet paraprake). Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Vlerësimi i stafit akademik/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 11 komponente për të cilat është gjetur nota mesatare. Rezultate e vlerësimit janë paraqitura në tabelën nr.3, nga të dhënat e prezantuara vërejmë se i gjithë stafi akademik/lënda janë vlerësuar pozitivisht nga studentët, nota mesatare në nivel të programit për mësimdhënës/lëndë është 4.26 një vlerësim i shkëlqyeshëm për punën dhe angazhimin e mësimdhënësve në lëndët përkatëse.

**Tabela nr.3 - Vlerësimi i stafit akademik / lëndës**

Emri i Lëndëve	Vitet paraprake		Viti aktual
	2021/22	2022/23	2023/24
Informatika ne biznes	4.36	3.70	4.33
Matematika për biznes	4.33	4.11	4.27
Mjedisi Biznesor	///	4.40	4.45
Hyrje ne ekonomi	4.33	4.25	4.51
Shkathhtësi akademike dhe komunikim në Biznes	4.14	3.10	4.24
Menaxhmenti	4.31	4.12	4.31
Vendimmarrja ne Biznes	///	4.00	4.21
Menaxhimi i Inovacioneve	///	4.14	4.36
Statistika Biznesore	4.13	4.19	3.99
Gjuhe Angleze I	4.10	3.95	4.19
Gjuhe Gjermane I	4.15	3.90	4.18
CAD	4.32	4.72	///
Përpunimi i metaleve dhe makinat metalprerëse	4.10	3.95	///
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	4.37	4.61	3.88
Marketingu	4.37	4.77	3.99
Teknika e matjes	4.20	///	///
Mbrojtja e ambientit	4.24	4.71	///
Gjuhe Angleze II	4.16	4.28	3.50
Praktika profesionale (Ditari i praktikës)	3.91	4.17	///
Kontabiliteti	4.05	4.13	4.05
Menaxhimi i Financave	4.12	4.27	4.50
Ndërmarrësia	3.89	4.20	3.79
Menaxhimi i dijes	///	///	4.08
Hidraulika dhe termodinamika	3.62	///	///
Zhvillimi i produktit dhe proceseve teknologjike	4.02	///	///
Etika ne Biznes	4.14	4.12	///
Bazat e te dhenave	///	4.00	3.97
Menaxhimi i operacioneve	4.30	4.90	3.85

Menaxhimi i Cilësisë	<b>4.28</b>	<b>4.30</b>	<b>4.24</b>
Produkti dhe Vendosja e Çmimeve	<b>4.27</b>	<b>4.75</b>	<b>4.36</b>
Dizajni i Produktit	///	<b>4.75</b>	<b>4.13</b>
Teknologjite CNC	///	<b>4.95</b>	///
Mbrojtja dhe siguria ne Pune	<b>4.17</b>	<b>4.50</b>	<b>4.30</b>
Menaxhimi i projekteve	<b>4.14</b>	<b>3.90</b>	<b>4.04</b>
Ri-inxhinjeringu	<b>4.34</b>	<b>3.87</b>	///
Menaxhimi strategjik	<b>4.20</b>	<b>4.17</b>	<b>4.28</b>
E Drejta Biznesore	<b>4.35</b>	<b>4.90</b>	<b>4.41</b>
NVM dhe Mjedisi biznesore	<b>4.40</b>	<b>3.75</b>	<b>4.34</b>
Sjellja Organizative	<b>4.34</b>	<b>4.47</b>	<b>3.92</b>
Menaxhimi i transportit dhe shpedicionit	<b>4.44</b>	<b>3.73</b>	<b>4.42</b>
E-biznesi	///	<b>4.15</b>	<b>4.21</b>
E Drejta Biznesore dhe Etika	///	///	<b>3.97</b>
Gjuhe Angleze III	///	///	<b>3.40</b>
Menaxhimi i Sistemit Informativ ne Ndërmarrje	///	///	<b>4.06</b>
Qëndrueshmëria e Ambientit dhe Ndërmarrësia	///	///	<b>4.31</b>
Analiza e Tregut dhe Sjellja Konsumatore	///	///	<b>4.11</b>
Ndërmarrësi Sociale	///	///	<b>4.31</b>
Gjuhe Gjermane II	///	///	<b>4.23</b>
Gjuhe Gjermane III	///	///	<b>4.01</b>
<b>Mesatarja e përgjithshme</b>	<b>4.20</b>	<b>4.23</b>	<b>4.26</b>

Duke u bazuar në të dhënat e përpunuara nga sistemi SMU (Sistemi i Menaxhimit Unversitar) të prezantuara në tabelën nr.3 (vlerësimi i stafit akademik / lëndës), vijmë në përfundimin se ka disa mësimdhënës dhe lëndë të cilat kanë marrë një vlerësim ma të lartë - mbi notën 4 - dhe ka disa mësimdhënës dhe lëndë qe kanë marrë një vlerësim ma të ulët - nën notën 4, në bazë të këtyre të gjeturave rekomandohet që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të rritur nivelin e përgjegjesisë profesionale nga mësimdhënësit në të gjitha lëndët të cilat kanë një vlerësim me notën nën 4, duke bërë përpjekje që këto vlerësime të përmirësohen në vitet pasuese dhe njëkohësisht stafi duhet të mbajë nivelin e mësimiit te ato lëndë që janë vlerësuar me notë mbi 4, duke pasur tendence të përmirësimit të vazhdueshëm.